



KUVENDI KOMUNAL GJILAN
KËSHILLI DREJTUES I TEATRIT TË QYTETIT GJILAN

STATUTI

I TEATRIT TË QYTETIT GJILAN

Gjilan, Gusht 2023

Bazuar në dispozitat e nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të ligjit për Teatrot, nr.04/L-106, Kuvendi I Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 04.08.2023 miraton:

STATUTIN **e Teatrit të Qytetit Gjilan**

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Me dispozitat e këtij statuti rregullohet statusi juridik, Themelimi, veprimtaria, Mënyra e financimit, misioni dhe vizioni, transparenca e Teatrit të Qytetit të Gjilanit (në tekstin e mëtejshëm: TQGJ).

Neni 2 E drejta e lirisë krijuese

Organet drejtuese të TQGJ garantojnë të drejtën e lirisë krijuese për të gjitha format artistike skenike në përputhje me kushtetutën e republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 3 Historiku i Teatrit

TQGJ veprimtarinë e vetë e zhvillon prej vitit 1944 në Gjilan.

Neni 4 Statusi dhe emërtimi

1. Emërtimi i teatrit është: "Teatri i Qytetit Gjilan" në Gjilan, ndërsa emërtimi i shkurtë është: "TQGJ".
2. TQGJ selinë e ka në Gjilan, Sheshi "Agim Ramadani" p.n.
3. TQGJ ka status të personit juridik dhe është institucion publik komunal.
4. TQGJ është institucion kulturor i pavarur nga subjektet politike dhe nga grupet e tjera të interesit.

Neni 5 Selia, Logo dhe Vula

1. Teatri i Qytetit Gjilan, ka selinë e vet, në sheshin Agim Ramadani, p.n. 60000, Republika e Kosovës

2. Logo e teatrit përmban simbolikisht dy maskat e teatrit të cilat janë të ngjizura e të shkruara njëra me tjetrën. Logo përmban tri nuanca të ngjyres së kuqe dhe ka formë katrore me disa thyerje ovale në fund. Në mes ka një rreth të plotë i cili simbolizon dritën apo reflektorët e teatrit ndërsa lartë me hijëzim janë të paraqitura perdet si simbole të teatrit. Nga ana e djathtë figuron teksti “Teatri i Qytetit Gjilan”
3. Teatri i Qytetit Gjilan, ka vulën katrore, identike me logon e TQGJ, por me dimensione 2cm X 2cm.
4. Teatri i Qytetit Gjilan, ka vulën protokolare, identike me logon e TQGJ, por me dimensione 2cm X 4cm.

Neni 6 Vizioni

TQGJ synon të ofrojë ndërveprim përmes formave artistike të teatrit duke krijuar hapësirë për eksplorime, hulumtime, rjetizime e zhvillime socio-kulturore me vepra artistike që trazojnë mendjet e njerëzve në kontekst edukativ e kulturore në Gjilan, Kosovë e më gjerë.

Neni 7 Misioni

TQGJ synon të ofrojë ndërveprim përmes formave artistike të teatrit duke krijuar hapësirë për eksplorime, hulumtime, rjetizime e zhvillime socio-kulturore me vepra artistike që trazojnë mendjet e njerëzve në kontekst edukativ e kulturore në Gjilan, Kosovë e më gjerë.

Neni 8 Veprimtaria

Veprimtaria e TQGJ i shërben të mirës së përgjithëshme dhe financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Teatri ushtron këto veprimtari:

1. Vlerësimin dhe vendimmarrjen për të nxitur, mbështetur dhe realizuar veprimtarinë teatrore brenda institucionit;
2. Bashkëpunimi me autoritetet publike si dhe me institucionet, organizatat dhe bashkëpunon me institucionet homologe të vendeve të tjera, bashkëpunon dhe aderon në organizatat dhe asociacionet rajonale e ndërkombëtare nga fusha teatrore, si dhe merr pjesë në aktivitetet e tyre, e veçanërisht në festivale, konferenca, trajnime, dhe lloje tjera shkëmbimesh;
3. Zbatimi i politikave kombëtare në fushën e artit skenik.
4. Realizimi i së paku katër premierave teatrore (tri për të rritur dhe një për fëmijë) gjatë një viti kalendarik, respektivisht gjatë sezonit teatror.
5. Organizimi i festivaleve teatrore.

6. Menaxhimin e infrastrukturës së gjithëmbarshme të objektit në pronësi të saj sipas vendimit të KK-Gjilan si dhe menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit që ka marrëdhënie kontraktuale me Teatrin;
7. Zotësi juridike për të lidhur kontrata dhe për të hyrë në marrëdhënie detyrimore me palët për realizimin e veprave dhe aktiviteteve tjera teatrore;
8. Realizon repertorin e verifikuar artistik dhe të qëndrueshëm të shfaqjeve teatrore dhe aktiviteteve tjera të fushës së teatrit.

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I TEATRIT

Neni 9 Organet Drejtuese

1. Organet drejtuese dhe vendimmarrëse të Teatrit janë:

- 1.1. Këshilli Drejtues;
- 1.2. Drejtori i Përgjithshëm;
- 1.3. Udhëheqësi Artistik.

Neni 10 Këshilli Drejtues

1. Kompetencat, detyrat, mandati, funksionimi dhe puna e Këshillit Drejtues, është e rregulluar me me Ligjin Nr. 04/ L – 106 për teatrot, përaktësisht me Rregulloren 01/2022 për punën e Këshillit Drejtues të Teatrit të Gjilanit.

Neni 11 Drejtori i përgjithshëm dhe udhëheqësi artistik

1. Detyrat, kompetencat e të cilëve janë të rregulluara me ligjin 04-L 106 për Teatrot dhe akteve nënligjore.
2. Ligji për teatrot, i cili është aktualisht në fuqi, qëndron i publikuar në internet faqen e Teatrit të Gjilanit, së bashku më të gjitha aktet e tjera nënligjore të cilat ndërlidhen me qështjet e Teatrit të Qytetit Gjilan.

Neni 12 Njësitë organizative

Në kuadër të Teatrit veprojnë:

- a) Njësia e Artistike;
- b) Shërbimi i Teknikës dhe
- c) Shërbimi i Përgjithshëm Administrativ.

a). Njësia Artistike përfshin Ansamblin rezident dhe artistët tjerë kreativë të teatrit siç janë: aktorët, regjisorët, dramaturgët, skenografët, kostumografët, kompozitorët, disenjatorët e dritave, inxhinierët e zërimit, udhëheqësit / inspektorët e skenës, etj.

b). Shërbimi i Teknikës përfshin stafin teknik të Teatrit, që angazhohen në realizimin teknik të shfaqjes dhe është i lidhur drejtpërdrejt me punët në skenë siç janë: inspicientët, dekoratorët, rekuizitorët, kabllomanët, tonistët, grimerët, garderobierët dhe punëtorët tjerë teknik.

c). Shërbimi i Përgjithshëm Administrativ përfshinë administratën dhe shërbimet tjera të Teatrit siç janë: juristi, ekonomisti, udhëheqësit e skenave, zyrtari/ja i marketingut, organizatori, asistenti/ja administrativ/e, bibliotekisti, arkivisti, biletashitësi, furnizuesi, pjesëtarët e sigurimit të objektit, pastruesit dhe stafi tjetër ndihmës në shërbimet e përgjithshme.

Neni 13 Ansambli rezident

1. TQGJ ka ansambël rezident, të përbërë prej më së paku 10 (dhjetë) deri në 20 (njëzet) aktorë cilësorë, të të gjitha gjeneratave dhe me balancë gjinore.
2. Me këtë ansambël Teatri realizon plan programin e paraparë artistik.
3. Me propozim të Udhëheqësit Artistik ose të Drejtorit të Përgjithshëm, aty ku mungon pozita e Udhëheqësit Artistik, mund të angazhohen edhe aktorë tjerë me kontratë për shërbime të veçanta në projekte të caktuara.
4. Teatri ka të drejtë të ketë të punësuar regjisorë/ artistë të tjerë kreativ të rregulltë të brendshëm të cilët hyjnë në kuadër të Njesisë Artistike së Teatrit.
5. Organizimi, themelimi, zhvillimi i trupës rezidente rregullohet me ligjin për Teatrot, aktet nënligjore dhe kontratën e punës në mes të TQGJ dhe aktorit të trupës rezidente.

Neni 14 Bashkëpunëtorët e Teatrit

1. Gjatë prodhimit të shfaqjeve teatrore, TQGJ lidh kontratë për shërbime të veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm, për projekte artistike, me të cilët lidh kontratë drejtori i përgjithshëm i teatrit.
2. Përzgjedhjen e stafit të jashtëm kreativ duhet ta bëjë udhëheqësi artistik në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm, sa i përket mundësive buxhetore.

Neni 15 Repertori

1. TQGJ është teatër i repertorit.
2. Teatri realizon repertor të qëndrueshëm dhe të verifikuar artistikisht.
3. Teatri obligohet të realizojë së paku katër premiera (Tri për të rritur dhe një për fëmijë) gjatë vitit kalendarik.
4. Një herë në muaj, pos programit për të rritur ofron edhe shfaqje për fëmijë dhe shfaqje nga teatrot mysafire.

5. TQGJ ka 2 (dy) sezone artistike brenda një viti kalendarik. Sezoni i parë fillon nga muaji janar e deri në fund të muajit qershor. Sezoni i dytë artistik fillon nga muaji shtator e deri në fund të muajit dhjetor.
6. Teatri pushon aktivitetin e tij artistik në muajin korrik dhe gusht.
7. Punonjësit e teatrit kanë orar fleksibil të punës për shkak të natyrës së veçantë të punës me prova në teatër. Programi dhe orari i tyre bëhet çdo muaj nga teatri, sipas politikave artistike e menaxhuese të zhvillimit të repertorit artistik.

Neni 16 Produksioni i Teatrit

1. Projektet artistike të krijuara nga TQGJ, janë pronë e Teatrit të Qytetit Gjilan
2. Në bashkëprodhime/ projekte të përbashkëta, pronësia rregullohet me kontratë në përputhje me ligjet në fuqi.
3. Të gjitha prodhimet teatrore nga TQGJ, duhet të bëhen në përputhje me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

Neni 17 Aktivitetet e Teatrit të Qytetit Gjilan

1. TQGJ prioritet ka performimin në sallën e Teatrit të Qytetit Gjilan.
2. Merr pjesë në performansa regjionale, në nivel të territorit të Kosovës, në rrafshin mbarëkombëtar dhe ndërkombëtarë, me paraqitje si repriza, turne, festivale, manifestime, revista dhe bashkepunime të tjera.
3. Pjesëmarrja me shfaqje jashtë teatrit të Qytetit Gjilan, bëhet me propozim të udhëheqësit artistik në koordinim me Drejtorin Gjeneral për mundësitë financiare dhe me aprovim nga këshilli Drejtues.

Neni 18 Shmangia e konfliktit të interesit

1. Drejtori i përgjithshëm dhe udhëheqësi artistik, gjatë kohës së vazhimit të mandatit të tyre, mund të veprojnë në mënyrë artistike dhe të zhvillojnë punët e tyre artistike jashtë teatrit ku punojnë vetëm me pëlqimin dhe miratimin me shkrim të Këshillit drejtues të teatrit, i cili në çfarëdo rasti duhet të përmbajë kushtet për kryerjen e punëve të tilla.
2. Drejtori i përgjithshëm, udhëheqësi artistik dhe anëtarët e Këshillit drejtues të teatrit nuk kanë të drejtë që gjatë mandatit të tyre të merren me punë krijuese të kontraktuara në teatrin ku punojnë.
3. Përjashtim nga paragrafi 2. i këtij neni bën nëse në Këshillin drejtues për anëtar emërohet ndonjëri nga trupa rezidente e teatrit.
4. Paraqitja e formave tjera të konfliktit të interesit zgjidhet duke u konsultuar me zyren ligjore të komunës së Gjilanit, zyren ligjore të MKRS-së dhe divizionit për shmangien e konfliktit të interesit pranë agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Neni 19
Mjetet buxhetore

1. Mjetet buxhetore për punën e Teatrit nënkuptojnë mjetet për program, paga, mirëmbajtje, udhëtim, mareliale, honorare, mëditje, ngrohje, ajrosje, investime kapitale, etj.
2. Mjetet buxhetore për punën e Teatrit të Gjilanit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Komuna e Gjilanit dhe Ministria për kulturë, rini dhe sporte
3. Mjetet buxhetore mund të sigurohen edhe nga sponsorizimet, testamentet, dhuratat, donacionet, grantet, bashkëprodhimet, memorandumet e bashkepunimit, në përputhje me ligjet në fuqi.
4. TQGJ, realizon të hyra nga biletat, me çmimin prej 2 eurove. Bileta për Punëtorët e Teatrit të Qytetit Gjilan, veteranët e luftës, invalidët e luftës, studentët dhe pensionistët ka çmimin 1 euro, shitja e të cilave bëhet vetëm me dëshmi.
5. Menaxhmenti i TQGJ, ka të drejtë t'i ndajnë më së shumti pesëdhjetë (50) ftesa, vetëm në rastet e premierave. Ftesa po ashtu duhet ta ketë të bashkëngjitur edhe biletën, me numrin rendor të ulëses përkatëse.
6. Për administrimin e aseteve financiare zbatohet legjislacioni në fuqi për Teatër.
7. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Teatri mund të krijojë të ardhura nga shitja e të drejtave të pronësisë mbi aktivitetin artistik, dhe nga çdo lloj aktiviteti tjetër i lejuar me ligjistacionin në fuqi.

Neni 20
Ndërtesa, hapësira dhe infrastruktura e teatrit

1. Ndërtesa, hapësirat dhe infrastruktura e Teatrit të Qytetit Gjilan, nuk mund të tjetërsohet dhe të ridestinohet për veprimtari jo artistike.
2. Hapësirat e TQGJ, mund të jepen në përdorim për aktivitete artistike të përkohshme, vetëm nëse ato nuk e pengojnë mbarvajtjen e programit të TQGJ.
3. Repertori i TQGJ është prioritet dhe nuk mund të ndryshoj nga programi i paraparë, për asnjë aktivitet tjetër jo teatror.
4. Mënyra e shfrytëzimit të sallës kryesore të teatrit rregullohet me rregulloren për shfrytëzimin e sallës, të aprovuar në kuvendin komunal dhe të hartuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 21
Arkiva

1. Teatri duhet të ruaj të gjithë dokumentacionin në arkivat e tij ose të Drejtorisë për Kulturë, në pajtim me ligjin për arkivat e Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi)
2. TQGJ obligohet t'i ruaj të gjitha materialet e produksioneve teatrore (Posterë, broshura, katalogje, fotografi, xhirime, etj)
3. Teatri mund të ketë kolanën e vet të botimeve për botimin e veprave dramatike të

autorëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë, për hulumtimin shkencor dhe dokumentues-historik në fushën e dramës dhe teatrit, botimin e katalogëve

Neni 22
Fondusi

Teatri ka fondusin e tij, në të cilin obligohet ta ruaj skenografinë, kostumet, rekuizitat, dhe materialet e tjera të nevojshme.

Neni 23
Shtojcat e Statutit

1. Përmajtja e vulës së TQGJ
2. Përmajtja e llogos së Teatrit të Qytetit Gjilan

Neni 24

Hyrja në fuqi e këtij statuti, shfuqizon statuti nr.

Neni 25
Hartimi dhe hyrja në fuqi


Ky vendim hyn në fuqi 15 pesëmbëdhjetë) pas regjistrimit në Zyren e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në web faqën e Komunës së Gjilanit.

01.Nr.016-82493

Gjilan, më 04.08.2023



Kryesues i KK Gjilan


Kushtrim Kadriu/